



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KURBIN  
KËSHILLI BASHKIAK KURBIN

Nr. 2054/ prot.  
h

Laç, më. 24 . 04 . 2023

VENDIM  
Nr. 26 datë 24.04.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.104 DATË 21.12.2022 "PËR MIRATIMIN E PAGËS SË PUNONJËSVE TË BASHKISË KURBIN, NJËSIVE DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI PËR VITIN 2023"**

Bazuar në ligjin 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 54 pika (ç), të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.604, datë 14.09.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Vendimin nr.113, datë 1.3.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", të Këshillit të Ministrave, si dhe në VKB nr.104, datë 21.12.2022 "Për Miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësive dhe Institucioneve në Varësi Për Vitin 2023", pas propozimit nga Kryetaria e Bashkisë dhe nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 24.04.2023;

**VENDOSI:**

1. Të gjithë punonjësit e miratuar në organikë sipas VKB nr.104, datë 21.12.2022 "Për Miratimin e pagës së punonjësve të Bashkisë Kurbin, Njësive dhe Institucioneve në Varësi për Vitin 2023", që kanë patur nivel page në masën 34'000 (tridhjetë e katër mijë) lekë, të bëhet 40'000 (dyzet mijë) lekë.
2. Ky vendim i shtrin efektet financiare nga data **01.04.2023**.

- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
- Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

- Prefektit të Qarkut Lezhë
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore
- Drejtoria e Financës
- Arkivi

SEKRETARI I KËSHILLIT

Arber LEKA

KRYETARE E KËSHILLIT

Edlira LLESHI